



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 17 shkurt 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe
Çështje lidhur me Të**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 95(2)(b) dhe 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes.²

2. Më 22 janar 2021, pas parashtrimeve me shkrim dhe me gojë të palëve,³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim kornizë lidhur me nxjerrjen e materialeve ("Vendimi Kornizë"), i cili përcakton, *ndër të tjera*, afatet për Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") për përmbushjen e detyrimeve për nxjerrjen e materialeve sipas Rregullores.⁴

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

² KSC-BC-2020-07, F00089, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Seancës për Vetëdeklarim në lidhje me Fajësinë ose Pafajësinë dhe të Konferencës së Parë për Ecurinë e Çështjes dhe Çështje të lidhura me To*, 18 dhjetor 2020, publik; Transkript, 8 janar 2021 ("Konferenca e Parë mbi Ecurinë e Çështjes"), publik.

³ KSC-BC-2020-07, F00096, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes ("Parashtrimet e ZPS-së")*, 5 janar 2021, publike; F00099, Mbrojtja e z. Haradinaj, *Parashtrime të Mbrojtjes në Emër të Nasim Haradinajt për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes ("Parashtrimet e Haradinajt")*, 7 janar 2021, publike; F00100, Mbrojtja e z. Gucati, *Parashtrime të Mbrojtjes për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes ("Parashtrimet e Gucatit")*, 7 janar 2021, publike; Konferenca e Parë mbi Ecurinë e Çështjes, f. 92-94, 101, 108-120.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00104, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To*, 22 janar 2021, publik.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Në pajtim me rregullën 95(2)(b) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton afatet për nxjerrjen e materialeve dhe merr masa për të mundësuar nxjerrjen e materialeve në kohë.

4. Sipas rregullës 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferenca mbi ecurinë e çështjes, në qoftë se e gjykon të nevojshme, për: (i) organizimin e shkëmbimeve mes palëve për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; (ii) ndërmarrjen e hapave për të mundësuar çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes për t'u dhënë palëve mundësinë e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

III. DISKUTIM

5. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në pajtim me parashtrimet e ZPS-së dhe sipas Vendimit Kornizë, ZPS-ja duhet të përfundojë nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores dhe t'i japë Mbrojtjes njoftim të hollësishëm sipas rregullës 102(3) të Rregullores deri më 19 shkurt 2021.⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se nxjerrja e materialit shfajësues sipas rregullës 103 të Rregullores është kryer më 4, 6, 18 dhe 29 janar 2021.⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se një nxjerrje e mëtejshme e materialeve sipas rregullës 103 të Rregullores është kryer më 12 shkurt 2021.⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu parashtrimin e ZPS-së se një sasi e kufizuar materialesh të rregullës 107 është objekt i nxjerrjes sipas rregullës 102(3) të Rregullores.⁸

⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9, 13; Konferenca e Parë mbi Ecurinë e Çështjes, f. 93, rreshtat 2-3, f. 101, rreshtat 4-6, f. 108, rreshtat 3-6; Vendimi Kornizë, para. 85(b)-(c).

⁶ KSC-BC-2020-07, Paketat 2 të Nxjerrjes së Materialeve (si pjesë e materialit të rregullës 102(1)(a)), 3-5. *Shih gjithashtu* Vendimi Kornizë, para. 85(h).

⁷ KSC-BC-2020-07, Paketa 6 e Nxjerrjes së Materialeve.

⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 16; Konferenca e Parë mbi Ecurinë e Çështjes, f. 115, rreshtat 5-11. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej se aktualisht ka marrë për shqyrtim dy kërkesa të ZPS-

6. Në pajtim me rregullën 96(1) të Rregullores dhe për të siguruar përgatitje të shpejtë për gjykimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencën e dytë mbi ecurinë e çështjes të mërkurën, 24 shkurt 2021, në orën 11:00, për të rishikuar ecurinë e procesit të nxjerrjes së materialeve dhe për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm të nevojshëm për përgatitjen për gjykim.

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve të bëjnë përditësimet e tyre përkatëse, nëse kanë, lidhur me pikat ende të pazgjidhura, të trajtuara në konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes dhe në Vendimin Kornizë. Konkretisht dhe gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë parashtrime në lidhje me pikat në vijim, sipas rendit të përcaktuar më poshtë:

(1) Nxjerrja e materialeve

a. Rregulla 102(1)(b) e Rregullores:

- i. nëse nxjerrja e materialeve sipas kësaj rregulle ka përfunduar, siç përcaktohet në Vendimin Kornizë; dhe
- ii. nëse pritet ndonjë nxjerrje e vonuar e materialeve sipas rregullës 102(1)(b)(ii) dhe (iii) të Rregullores përpara ose bashkë me parashtrimin e dosjes paraprake dhe materialit shoqërues sipas rregullës 95(4) të Rregullores, përfshirë numrin dhe llojin e atyre materialeve dhe nëse do të kërkohen masa mbrojtëse lidhur me to;

b. Rregulla 102(2) e Rregullores: nëse pritet ndonjë nxjerrje e vonuar e materialeve sipas kësaj rregulle përpara ose bashkë me parashtrimin e dosjes

së dhe përgjigjet përkatëse të Mbrojtjes sipas rregullës 108 të Rregullores. *Shih KSC-BC-2020-07, F00107, Prokurori i Specializuar, Kërkesë e Prokurorisë për Mosnxjerrjen e Informacionit të Caktuar në lidhje me Kontaktimin e Dëshmitarëve, 29 janar 2021, konfidenciale. F00110, Prokurori i Specializuar, Parashtrim i Prokurorisë lidhur me Nxjerrjen e Disa Dokumenteve të Sekuestruara prej Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së, 1 shkurt 2021, konfidencial, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte; F00127, Prokurori i Specializuar, Parashtrim i informacionit plotësues në lidhje me Parashtrimin e Protokolluar KSC-BC-2020-07/F00107, 16 shkurt 2021, konfidencial, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte.*

paraprake dhe materialit shoqërues sipas rregullës 95(4) të Rregullores dhe, nëse po:

- i. numrin e materialeve që pritet të nxirren, kohën e nxjerrjes së tyre dhe nëse përkthimet, nëse kërkohet me ligj, janë ose do t'i bëhen të disponueshme të akuzuarit; dhe
- ii. arsyet për nxjerrjen e vonuar të secilit prej materialeve të përmendura më lart;

c. Rregulla 102(3) e Rregullores:

- i. nëse Mbrojtjes i është dhënë njoftim i hollësishëm për provat sipas kësaj rregulle, siç përcaktohet në Vendimin Kornizë;⁹ dhe
- ii. nëse pritet ndonjë përfshirje e vonuar e materialeve në njoftimin e hollësishëm, përpara ose bashkë me parashtrimin e dosjes paraprake dhe materialeve shoqëruese sipas rregullës 95(4) të Rregullores dhe, nëse po:

1. numrin dhe llojin e materialeve që pritet të përfshihen në listën sipas rregullës 102(3) të Rregullores, datën kur lista e ndryshuar do t'i jepet Mbrojtjes, nëse do të kërkohen masa mbrojtëse lidhur me ato materiale, në rast të nxjerrjes së tyre; dhe
2. arsyet për përfshirjen e vonuar të secilit prej materialeve të përmendura më lart;

d. Rregulla 103 e Rregullores:

- i. nëse nxjerrja e materialeve në zotërim të ZPS-së, sipas kësaj rregulle, ka përfunduar;

⁹ Vendimi Kornizë, para. 85(c).

- ii. arsyet për nxjerrjen e materialit shfajësues më 12 shkurt 2021 në kuadrin e kalendarit në Vendimin Kornizë;¹⁰ dhe
 - iii. nëse pritet ndonjë nxjerrje e materialeve sipas kësaj rregulle në të ardhmen, përpara ose bashkë me parashtrimin e dosjes paraprake dhe materialit shoqërues sipas rregullës e 95(4) të Rregullores dhe, nëse po:
 - 1. numrin dhe llojin e materialeve që pritet të nxirren dhe kohën e nxjerrjes së tyre; dhe
 - 2. rrethanat që përlligjin kohën e nxjerrjes së materialeve të përmendura më lart;
 - e. Rregullat 107-108 të Rregullores: nëse ZPS-ja parashikon kërkesa të tjera në bazë të këtyre rregullave brenda afatit të parashikuar në paragrafin 10(c) dhe, nëse po, numrin e kërkesave të tilla dhe sasinë e materialit që është objekt i tyre; dhe
 - f. Duke mbajtur parasysh hapat e përfunduar në nxjerrjen e materialit provues nga ZPS-ja, nëse palët po përballen apo parashikojnë të përballen me ndonjë vështirësi sa i takon pjesës së mbetur të procesit të nxjerrjes së materialeve;
- (2) Hetimet e ZPS-së, parashtrimi i dosjes paraprake dhe përfundimi i procesit të nxjerrjes së materialeve:
- a. nëse kanë përfunduar hapat hetimorë të papërfunduara të ZPS-së, ose nëse mund të jepet një vlerësim për datën e përfundimit të tyre; dhe
 - b. bazuar në vlerësimet e ZPS-së në lidhje me të gjitha pikat e përmendura më lart dhe pjesën e mbetur të procesit të nxjerrjes së materialeve, nëse ZPS-ja pret të jetë në gjendje të dorëzojë dosjen paraprake dhe materialet shoqëruese, së

¹⁰ Vendimi Kornizë, para. 85(h).

bashku me tabelën përmbledhëse sipas rregullës 109(c),¹¹ deri më 9 prill 2021, dhe nëse ajo do të mund ta përfundojë nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102 të Rregullores deri në të njëjtën datë; ose

- c. nëse ZPS-ja është në gjendje të propozojë një datë më të hershme ose më të vonë për përfundimin e hapave të lartpërmendur;

(3) Pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen:

- a. nëse palët kanë hyrë në diskutime lidhur me mundësinë e parashtrimit të pikave juridike dhe/ose faktike për të cilat palët pajtohen, në pajtim me rregullën 95(3) dhe 156 të Rregullores; dhe
- b. kur palët presin të jenë në gjendje të identifikojnë një listë pikash për të cilat nuk pajtohen dhe një listë pikash për të cilat pajtohen;

(4) Hetimet e Mbrojtjes dhe hapat proceduralë në lidhje me to:

- a. nëse Mbrojtja është në gjendje të japë përditësime për statusin e hetimeve të saj dhe një vlerësim për kohën që do t'i duhet për t'i përfunduar ato;
- b. bazuar në vlerësimin e Mbrojtjes lidhur me pikën e mësipërme, nëse, që nga konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes,¹² ajo ka bërë ndonjë përparim lidhur me:
- i. synimin e vet për të dhënë njoftim për alibi ose arsye që përjashtojnë përgjegjësinë penale sipas rregullës 95(5) të Rregullores dhe çdo nxjerrje shoqëruese të materialeve sipas rregullës 104(1) dhe (2) të Rregullores; dhe
 - ii. synimin e vet për të bërë kërkesa lidhur me mundësi hetimore unike, në pajtim me rregullën 99(1) të Rregullores;

¹¹ KSC-BC-2020-07, F00121, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Parashtrimet në lidhje me Kategorizimin sipas Rregullës 109(c)*, 11 shkurt 2021, publik, para. 23(d).

¹² Parashtrimet e Gucatit, para. 14; Parashtrimet e Haradinajt, para. 6.

- c. nëse Mbrojtja parashikon dorëzimin e dosjes paraprake dhe materialeve shoqëruese sipas rregullës 95(5) të Rregullores, dhe, nëse po, kur mendon se do të jetë në gjendje t'i dorëzojë ato;
- (5) Kalimi i pritshëm i dosjes së çështjes sipas rregullës 72(1) të Rregullores: në varësi të nxjerrjeve të papërfunduara të materialeve nga ZPS-ja dhe me kusht që Paneli i Gjykatës së Apelit të ketë marrë vendimet mbi mocionet paraprake, pikëpamjet e palëve për kalimin e dosjes së çështjes trupit gjykues rreth mesit të prillit 2021, në pajtim me rregullën 72 të Rregullores lidhur me procedimin e përshpejtuar; dhe
- (6) Kur mendojnë palët të jenë gati për gjykim.
8. Së fundi, palëve do t'u kërkohet të japin pikëpamjet e tyre në lidhje me datën për mbajtjen e konferencës së ardhshme mbi ecurinë e çështjes.
9. Palët ftohen të dorëzojnë parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, deri të martën, 23 shkurt 2014, në orën 14:00, për cilëndo nga pikat e mësipërme, përfshirë temat e diskutuara në konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes, ose për çfarëdo pike tjetër në lidhje me sa më lart që nuk trajtohet në këtë urdhër.

IV. VENDIM

10. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:
- a. **VENDOS** të mbajë seancë në prani të ZPS-së dhe Mbrojtjes, në pajtim me paragrafët 6-8, të **mërkurën, 24 shkurt 2021, në orën 11:00**;
 - b. **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen të dorëzojnë parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, deri të **martën, 23 shkurt 2021, në orën 14:00**, në pajtim me paragrafin 9;
 - c. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë çdo kërkesë të pritshme sipas rregullave 107-108 të Rregullores, deri të **premtën, 19 mars 2021**, dhe **URDHËRON**

Mbrojtjen t'i përgjigjet, nëse dëshiron, çdo kërkesë të tillë **brenda pesë (5) ditësh** nga njoftimi.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 17 shkurt 2021
Në Hagë, Holandë.